



Grant Thornton

Raporti Financiar dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013

Përmbajtja

| | Faqe |
|---|------|
| Raporti i Auditorit të Pavarur | 1 |
| Pasqyra e Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve | 3 |
| Shënimer e Pasqyrës së Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve | 4 |
| Shtojca 1 Mjetet Fikse | 11 |

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Prishtina
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Menaxhmentin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Ne kemi audituar raportin financiar të Asociacionit të Komunave të Kosovës ("Asociacioni"), të cilat përfshijnë pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013 dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informatave tjera sqaruese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për raportin financiar

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportit financiar në përputhje me bazën kontabël të pranimit dhe pagesave në para te gatshme dhe për kontrollin e tilla që menaxhmenti përcakton se janë të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi raportin financiar bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse raporti financiar është pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe shpalosjet në raportin financiar. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të raportit financiar si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm relevant në përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportit financiar të entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të raportit financiar.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.



Opinion

Sipas opinionit tonë, raporti shoqërues financiar paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të hyrat e mbledhura dhe shpenzimet e paguara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013 në përputhje me parimin kontabël të pranimeve dhe pagesave në para te gatshme.

Çështje tjetër

Raporti financiar i Asociacioni i Komunave të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012 është audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion te pamodifikuar mbi atë raport më 1 Mars 2013.

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze, në rast mospërputhjeje midis këtyre dy raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

GRANT THORNTON LLC

Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
14 Shkurt 2014

Pasqyra e Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve

| | Shënimet | Për fundvitin më 31 Dhjetor 2013 (Në EUR) | Për fundvitin më 31 Dhjetor 2012 (Në EUR) |
|--|----------|---|---|
| Burimet e fondeve | | | |
| Fondet e donatoreve | 3 | 185,218 | 317,412 |
| Pjesëmarrja komunave në të hyra | 4 | 81,092 | 116,897 |
| Të hyrat e tjera | | 2,935 | 7,258 |
| Totali fondet ne dispozicion | | 269,246 | 441,567 |
| Përdorimi i fondeve | | | |
| Shpenzimet e personelit | 5 | 137,544 | 148,635 |
| Lobimi / Avokimi | 6 | 69,493 | 132,985 |
| Pajisje dhe furnizime të zyrës | 7 | 10,323 | 21,982 |
| Shërbime të zyrës | 8 | 22,240 | 23,311 |
| Shpenzimet e udhëtimit | 9 | 9,348 | 13,230 |
| Komunikimet dhe publikimet | 10 | 30,852 | 38,529 |
| Ngritja e kapaciteteve | 11 | 25,088 | 7,557 |
| Shpenzimet e tjera | 12 | 11,658 | 12,236 |
| Totali i shpenzimeve | | 316,547 | 398,465 |
| (Deficiti) / Suficiti i fondeve të pranuar mbi shpenzimet | | (47,301) | 43,102 |
| Fundet e kthyer te donatorët | 3 | (6,327) | (831) |
| (Deficiti) / Suficiti i fondeve | | (53,628) | 42,271 |
| Gjendja fillestare e parasë së gatshme dhe ne bankë | | 97,681 | 55,410 |
| Paraja e gatshme dhe në bankë në fund të periudhës | 13 | 44,053 | 97,681 |

Ky raport financiar është aprovuar nga Menaxhmenti më 14 Shkurt 2014 dhe nënshkruar në emër të tij nga:


Sazan Ibrahim
Drejtor Ekzekutiv


Mexhit Shaqiri
Menaxher Financiar



Shënimet e Pasqyrës së Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve

1 Hyrje dhe politikat operative

Asociacioni i Komunave të Kosovës ("Asociacioni") është regjistruar në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut si organizatë jo qeveritare më 17 Dhjetor 2002 dhe operon në Prishtinë. Me numër të regjistrimit 5101800-1.

Misioni

Misioni i Asociacionit është që të krijojë qeverisje lokale efektive, të qëndrueshme dhe demokratike përmes performancës së kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave të qytetarëve të saj.

Qëllimi

Asociacioni i Komunave të Kosovës është interes i përbashkët i pjesëtarëve për kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron.

Asociacioni ka karakter profesional e asesi politik, me obligim të demokratizimit të mëtutjeshëm të shoqërisë kosovare.

Asociacioni do të jetë organizëm i fortë midis pushtetit lokal dhe atij qendror, duke i mbrojtur pareshtur kompetencat e komunave nga tendencat centraliste si dhe duke i avancuar ato në harmoni me aktet në fuqi.

Asociacioni, përveç demokratizimit të shoqërisë (përmes demokratizimit të institucioneve), do të punojë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, forcimin e bashkëpunimit mes komunave si dhe në integrimin e komuniteteve në shoqërinë kosovare.

Qëllim kryesor i këtij Asociacioni do të jetë qeverisja e mirë dhe e suksesshme në nivelin lokal, duke i dalë zot përgjegjësisë së dhënë në të gjitha fushat shoqërore që i përkasin

Asociacioni do të ketë synim harmonizimin e niveleve të ndryshme të qeverisjes si dhe flakjen e paralelizmave të panevojshme, pavarësisht nga adresohen.

Asociacioni do të bashkëpunojë dhe aderojë me asociacionet simotra evropiane – ndërkombëtare si dhe do të bazohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale (neni 4, artikulli 6) ku thuhet: bashkësive lokale duhet t'u kërkohet mendimi, Brenda mundësive, në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti, duhet respektuar.

1 Hyrje dhe politikat operative (vazhdim)

Objektivat

Përmirësimi i strukturave legislative të vetëqeverisjes dhe efikasiteti praktik i implementimit të tyre;

Nxitja e decentralizimit të pushtetit, përmes mbështetjes praktike dhe bashkëpunimit mbi baza të barabarta, mes Autoriteteve qendrore dhe atyre lokale;

Zgjerimi i mbështetjes publike për demokracinë lokale që përfshin qytetarët dhe komunitetin e biznesit dhe ngritja e besimit në vetorganizimin e tyre dhe gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë në qeverisjen lokale;

Rritja e kompetencave, njohurive dhe kapaciteteve të Komunave për të siguruar kualitete të larta dhe efektive në shërbimet lokale;

Gjetja e burimeve alternative financiare për Komunitat;

Demonstrimi se Komunitat e Kosovës janë të barabarta dhe kanë partneritet konkurrues me Autoritetet lokale në Evropë dhe në mbarë Botën;

Mbështetja e zhvillimit të Asociacionit në përputhje me ndryshimet në qarqet e brendshme dhe të jashtme.

2 Politkat Kontabël

2.1 Baza e pregaditjes

Raporti financiar është përgatitur në përputhje me bazën kontabël të pranimit dhe pagesave në para te gatshme. Sipas parimit të pranimit dhe pagesave në para gatshme, të hyrat njihen kur pranohen e jo kur fitohen, dhe shpenzimet njihen kur paguhen dhe jo kur ndodhin. Kostot që lidhen me blerjen e aseteve fikse nuk janë të kapitalizuara.

Të gjitha të dhënat në raportin financiar janë të shprehura në Euro (valuta ligjore në territorin e Kosovës). Sipas nevojës, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në mënyrë që të jenë në përputhje me prezantimin e vitit aktual

3 Fondet e donatorëve

| | 31 Dhjetor 2013 (Në Euro) | 31 Dhjetor 2012 (Në Euro) |
|---|------------------------------|------------------------------|
| SDC | 136,000 | 150,000 |
| WHO | 10,640 | - |
| MAPL | 9,800 | - |
| AMICI DEI BAMBINI | 7,200 | - |
| NALAS | 6,600 | 36,484 |
| COUNCIL OF EUROPE 2013 | 6,585 | - |
| Helvetas Swiss Intercooperation – LOGOS | 4,500 | - |
| COUNCIL OF EUROPE 2012 | 3,893 | 3,910 |
| DFID-COFFEY | - | 60,924 |
| GIZ | - | 48,800 |
| GIZ-NALAS "OPEN REGIONAL FUND" | - | 10,501 |
| ILO-IPEC | - | 3,864 |
| COUNCIL OF EUROPE 2011 | - | 2,929 |
| Totali i Fondit të Donatorëve | 185,218 | 317,412 |

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) me 10 Korrik 2009, në shumën totale prej 716,000 Euro për projektin "Mbështetja e SDC për Asociacionin e Komunave të Kosovës" për periudhën prej 1 Korrik 2009 deri më 31 Dhjetor 2013. Gjatë vitit 2013, Asociacioni ka pranuar një shumë prej 136,000 Euro në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Helvetas Swiss Intercooperation më 3 Mars 2013 në shumë prej 5,890 euro për projektin "Lobimi mbi financat komunale" për periudhën prej tre muajsh. Gjatë vitit 2013, Asociacioni ka pranuar një shumë prej 4,500 Euro në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) më 10 Shkurt 2012 për të mbështetur projektin "Fuqizimi dhe Zhvillimi i Rinisë në Kosovë", me shumën prej 48,800 Euro për periudhën nga 2 Shkurt 2012 deri më 28 Dhjetor 2012. Gjatë vitit 2013 Asociacioni i ka kthyer GIZ fondet në shumë prej 6,327 Euro.

3 Fondet e donatorëve (vazhdim)

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Këshillin e Evropës më 30 Maj 2012 për të mbështetur organizimin e "Programit të praktikave më të mira" të mbajtur nga Qershori deri në Dhjetor 2012 për një shume maksimale prej 7,820 Euro. Gjatë vitit 2013 në lidhje me këtë kontratë, Asociacioni ka pranuar një shumë prej 3,893 Euro.

Asociacioni ka nënshkruar marrëveshje administrative me Këshillin e Evropës më 2 Shkurt 2013 për të mbështetur shpenzimet në lidhje me organizimin e Programit për Praktikën më të Mirë (Faza II) mbajtur nga Shkurti në Tetor 2013 në Kosovë për një shume maksimale prej 13,170 Euro. Gjatë vitit 2013, Asociacioni ka pranuar një shumë prej 6,585 Euro në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar aneks kontratë për donacion me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) më 1 Janar vitin 2013 për angazhimin e një Asistenti të Menaxhimit të Njohurive Kombëtare nga NALAS për një shumë prej 150 euro në muaj për periudhën nga 1 Nëntor 2012 deri më 31 Dhjetor 2013. Gjatë vitit 2013 Asociacioni ka pranuar një shumë prej 2,100 euro në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) më 4 Janar, 2013 për angazhimin një Asistenti shtese të Menaxhimit të Njohurive Kombëtare nga NALAS për një shumë prej 500 Euro në muaj për periudhën nga 1 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013. Gjatë vitit 2013 Asociacioni ka pranuar një shumë prej 4,500 euro në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH) më 3 Mars 2013 për projektin "Forcimi i zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në komunave e Kosovës" për periudhën prej 18 Mars 2013 deri më 18 Gusht 2013 për një shume maksimale prej 13,300 EUR. Gjatë vitit 2013, Asociacioni ka pranuar një shumë prej 10,640 Euro në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Amici de Bambini më 5 Janar 2013 për projektin "forcimin e shërbimeve sociale në favor të fëmijëve në ngarkim tek shërbimet sociale për arsye familjare". Periudha e përgjithshme e projektit është nga 1 Korrik 2012 deri më 31 Dhjetor 2012 për një shumë prej 7,200 Euro, të cilat janë pranuar nga Asociacioni gjatë vitit 2013.

Asociacioni ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më 10 Tetor 2013 për projektin "20 Udhëzimet / Sygjerimet për kryetarin e Bashkisë" për periudhën 3 mujore për një shumë prej 9,800 Euro i cili u pranua nga Asociacioni gjatë vitit 2013.

4 Pjesëmarrja e komunave në të hyra

| | 31 Dhjetor 2013 (Në Euro) | 31 Dhjetor 2012 (Në Euro) |
|--|------------------------------|------------------------------|
| PRISHTINE | 26,600 | 28,339 |
| GJILAN | 7,758 | 7,758 |
| MITROVICE | 5,034 | 7,758 |
| PODUJEVE | 5,000 | 5,233 |
| PEJE | 4,037 | 8,074 |
| KAMENICE | 3,958 | 3,958 |
| SKENDERAJ | 3,958 | - |
| PRIZREN | 3,879 | 15,515 |
| VITI | 3,640 | 3,641 |
| ISTOG | 3,166 | 2,375 |
| GJAKOVA | 2,690 | 8,074 |
| KAÇANIK | 2,375 | 2,375 |
| SHTIME | 2,058 | 2,058 |
| OBILIQ | 1,900 | 1,900 |
| VUSHTRRI | 1,346 | - |
| DRAGASH | 1,267 | 1,900 |
| RAHOVEC | 1,000 | 1,000 |
| HANI I ELEZIT | 792 | 792 |
| MAMUSHE | 317 | 316 |
| NOVOBËRDË | 317 | 316 |
| FERIZAJ | - | 7,916 |
| DRENAS | - | 4,274 |
| FUSHË KOSOVË | - | 2,533 |
| JUNIK | - | 792 |
| Totali i Pjesmarrjes së Komunave në të Hyra | 81,092 | 116,897 |

Sipas vendimit të Kuvendit të Shoqatës me 27 Shkurt 2008 dhe në përputhje me paragrafin 3.2 dhe 3.3 të Statutit të Shoqatës themeluesit e organizatës (komunat) janë të obliguar që të paguajnë një pagesë mujore, siç është e aprovuar nga Kuvendi i Shoqatës. Ky obligim paguhet nga secila komunë në bazë të numrit të popullatës dhe vlerën e grant- it të cilën e kanë pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Për fund vitin më 31 Dhjetor 2013 Asociacioni të ketë marrë një shumë prej 81,092 Euro si tarifë të anëtarësisë nga komunat (Për fund vitin më 31 Dhjetor 2012: 116,897 euro). Kjo shumë shërben si buxheti operativ të Shoqatës, ajo është përdorur për mbulimin e shpenzimeve operative dhe administrative të zyrës së Shoqatës

5 Shpenzimet e Personelit

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|--|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Stafi i rregullt | 98,700 | 104,127 |
| Shpenzimet tjera të lidhura me stafin (tatimet dhe pensionet) | 22,760 | 25,578 |
| Konsultantët dhe ekspertët e jashtëm | 16,084 | 18,930 |
| | 137,544 | 148,635 |

6 Lobimi / Avokimi

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|---------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Takimet e kolegjiemeve | 22,300 | 36,130 |
| Takimet dhe konferencat Lokale | 15,458 | 33,942 |
| Vizitat studimore | 11,892 | 32,521 |
| Takimet dhe konferencat ndërkombëtare | 6,879 | 18,568 |
| Kuvendi i AKK-se | 9,813 | 9,319 |
| Përfaqësimi | 3,151 | 2,505 |
| | 69,493 | 132,985 |

7 Pajisjet dhe furnizimet e zyrës

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Pajisjet e zyrës (Pajisjet e zyrës, etj) | 1,413 | 9,591 |
| Pajisjet për zyrë (letra dhe materiale tjera) | 3,835 | 7,059 |
| Artikujt higjienike për zyrën | 1,500 | 1,500 |
| Pajisje tjera (Mobile, etj) | 875 | 1,129 |
| Artikuj tjerë | 2,700 | 2,703 |
| | 10,323 | 21,982 |

8 Shërbimet e zyrës

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|-----------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Përkthimi | 7,665 | 4,067 |
| Qiraja e Zyrës | 7,200 | 7,200 |
| Shërbimet Postare | 3,212 | 5,532 |
| Interneti | 1,526 | 1,816 |
| Energjia elektrike | 1,015 | 1,510 |
| Mirëmbajtja e pajisjeve dhe tjera | 862 | 1,365 |
| Uji | 400 | 261 |
| Mirembajtja e ndërteses/Sigurimi | 360 | 1,560 |
| | 22,240 | 23,311 |

9 Shpenzimet e udhëtimit

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|---------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Karburant për automjete | 4,925 | 4,584 |
| Transporti | 3,470 | 6,840 |
| Shpenzime tjera | 752 | 1,594 |
| Viza (taksat/shpenzimet) | 115 | 156 |
| Sigurimi i shëndetit në udhëtim | 86 | 56 |
| | 9,348 | 13,230 |

10 Komunikimet dhe publikimet

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Publikime të ndryshme (Deklarata Parimore etj.) | 23,111 | 26,009 |
| Buletini i AKK-se | 6,000 | 11,500 |
| Lajmërime të ndryshme, Reklama | 1,741 | 904 |
| Uebfaqja e Shoqatës/ IT | - | 116 |
| | 30,852 | 38,529 |

11 Ngritja e kapaciteteve

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Ngritja e planeve strategjike për kolegjiunin e AKK-se | 11,100 | - |
| Ngritja e analizave profesionale | 9,988 | - |
| Trajnimi i stafit | 4,000 | 5,197 |
| Ngritja profesionale e stafit | - | 2,360 |
| | 25,088 | 7,557 |

12 Shpenzimet tjera

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Mirëmbajtja e veturave (servisimi) | 6,991 | 7,537 |
| Shpenzimet për auditorin e pavarur | 3,364 | 3,364 |
| Kontigjencat | 499 | - |
| Provizioni i bankës | 486 | 794 |
| Karburant për gjeneratorin | 318 | 541 |
| | 11,658 | 12,236 |

13 Paraja e gatshme dhe në bankë

| | Për fund vitin 31 Dhjetor 2013 | Për fund vitin 31 Dhjetor 2012 |
|-----------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Paraja në bankë | 44,001 | 97,672 |
| Paraja në Dorë | 52 | 9 |
| | 44,053 | 97,681 |

Shtojca 1 Mjetet Fikse

| Përshkrimi | Data | Donatori | Cmimi i Blerjes |
|--------------------------------|--------------|----------|-----------------|
| Skaner i shpejtë për dokumente | Gusht 2006 | EAR | 3,925 |
| Kompjuterë | Gusht 2006 | EAR | 2,869 |
| Laptopa | Gusht 2006 | EAR | 1,518 |
| Projektor | Gusht 2006 | EAR | 277 |
| Kopjuës i CD-ve | Gusht 2006 | EAR | 3,090 |
| UPS | Gusht 2006 | EAR | 284 |
| Pajisje për Përkthim Simulant | Gusht 2006 | EAR | 27,916 |
| Kamerë Digjitale | Gusht 2006 | EAR | 325 |
| Ekran Portativ i Projektorit | Gusht 2006 | EAR | 1,534 |
| Kompjuterë | Nëntor 2009 | GTZ | 3,786 |
| Laptop | Nëntor 2009 | GTZ | 966 |
| Projektor Toshiba | Nëntor 2009 | GTZ | 1,241 |
| Printer | Nëntor 2009 | GTZ | 509 |
| Automjet (Passat) | Korrik 2008 | GTZ | 7,200 |
| Gjenerator për zyrë | Tetor 2006 | AKM | 950 |
| Automjet (PASAT) | Gusht 2009 | AKM | 19,500 |
| Kompjuterë | Shtator 2009 | AKM | 1,830 |
| Laptop | Shtator 2009 | AKM | 570 |
| Server i AKK-së | Tetor 2009 | AKM | 1,300 |
| Fotokopje | Shtator 2009 | AKM | 1,590 |
| Laptop DELL Inspiron N5110 | Dhjetor 2011 | AKM | 729 |
| Canon ALL IN ONE | Dhjetor 2011 | AKM | 266 |
| Laptop TOSHIBA Satellite | Tetor 2011 | GIZ | 639 |
| PC Fujitsu | Janar 2012 | AKM | 499 |
| Fotokopje | Qershor 2012 | AKM | 1,864 |
| Air Conditioner | Qershor 2012 | AKM | 435 |
| Air Conditioner | Qershor 2012 | AKM | 244 |
| Aparat fotografik | Korrik 2012 | AKM | 730 |
| Shneider | Korrik 2012 | AKM | 483 |
| TV Sony | Nëntor 2012 | AKM | 668 |
| | | | 87,737 |



Grant Thornton

www.grant-thornton.com.mk